



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 181

Tiranë – E mërkurë, 14 tetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 302, datë 8.10.2020	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Tweety”, Tiranë..... 12569
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 564, datë 9.10.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr. 351, datë 29.5.2020 “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19”, të ndryshuar..... 12570
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 57, datë 7.10.2020	Për miratimin e rregullores “Për operacionalizimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda dhe rasteve përjashtimore”..... 12571
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 58, datë 7.10.2020	Për përjashtimin nga mbajtja e komisioneve për llogaritë e hapura në sistemet e pagesave të Bankës së Shqipërisë, për administrimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme..... 12575
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020	Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmësligjor..... 12576



URDHËR

Nr. 302, datë 8.10.2020

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PRIVAT, KOPSHTI
“TWEETY”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar është dërguar nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ankesa me nr. 4712/1 prot., datë 10.9.2020, e znj. E.O. për institucionin arsimor parauniversitar privat, kopshti “Tweety” në Tiranë, në lidhje me shërbimin e ofruar nga ky kopsht.

Me urdhrin nr. 275, datë 15.9.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, u ngrit grupi i punës, i cili kreu verifikimet e nevojshme në ambientet e këtij institucioni arsimor parauniversitar privat, duke propozuar, në bazë të pikës 3, të nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhënien e dënimit administrativ plotësues të heqjes së licencës për ushtrimin e veprimtarisë së këtij institucioni.

Heqja e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së këtij kopshti bëhet për shkak të konstatimit të shkeljeve të rënda të legjislacionit në fuqi, që lidhen me kushtet e licencimit, për institucionin arsimor parauniversitar privat, kopshti “Tweety”, Tiranë, të evidentuar në Raportin e Vlerësimit nr. 2578/1 prot., datë 6.10.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, si më poshtë:

a) mungesa e plotësisht të kriterëve, për disa mësues, lidhur me ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit të arsimit parashkollor, në bazë të legjislacionit në fuqi.

b) drejtuesi didaktik i institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Tweety”, Tiranë, nuk zotëron kualifikimin e duhur, në përputhje me kërkesat ligjore për drejtuesin didaktik të institucionit (minimalisht kategorinë III të kualifikimit “Mësues i kualifikuar”);

c) mungesa e shërbimit psikosocial në kopshtin privat “Tweety”, Tiranë, në bazë të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar;

d) mosplotësimi i standardit normativ që lidhet me kushtet higjienike të përcaktuara në shkronjën “c”, pika 5, të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar;

e) mungesa e përkujdesjes ndaj fëmijëve gjatë kohës së qëndrimit të tyre në institucionin arsimor parauniversitar privat, kopshti “Tweety”.

PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3 të nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në Raportin e Vlerësimit nr. 2578/1 prot., datë 6.10.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Tweety”, Tiranë, në emër të personit fizik, znj. Miranda Metallari, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 3.11.2011, i identifikuar me numrin unik të subjektit (NUIS) L12303024R.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Tweety”, Tiranë, ka këto detyrime:

a) të kthejë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i fëmijës për pjesën e papërfunduar të frekuentimit të kopshtit, për vitin shkollor 2020–2021, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur, nëse ka;

b) të pajisë çdo fëmijë me dokumentacionin e nevojshëm shkollor që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

c) të vendosë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;



d) të mbulojë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e fëmijëve, në zbatim të këtij urdhri;

e) të dorëzojë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Tweety”, Tiranë ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Tweety”, Tiranë;

b) të marrë masat për transferimin e fëmijëve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë fëmijët e regjistruar në këtë institucion arsimor parauniversitar privat;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga ky institucion arsimor parauniversitar privat;

d) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Tweety”, Tiranë.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast moszbatimi të detyrimeve, nga personi fizik, të përcaktuar në pikën 2, të këtij urdhri, që përfaqëson institucionin, arsimor parauniversitar privat, kopshtin “Tweety”, Tiranë, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 31, datë 9.2.2001 i ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore

Parauniversitare, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Tweety”, Tiranë dhe personi fizik, znj. Miranda Metallari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

URDHËR
Nr. 564, datë 9.10.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR.
351, DATË 29.5.2020 “PËR MARRJEN E
MASAVE TË VEÇANTA DHE
KUFIZIMEVE PËR PARANDALIMIN E
PËRHAPJES SË COVID-19”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe vendimit të Komitetit Teknik nr. 4540, datë 9.10.2020,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 351, datë 29.5.2020 “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Në pikën 3, germa “b”, termi “kinematë”, shfuqizohet.

2. Aktiviteti i kinemave të ofrohet në përputhje me protokollet e miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik për parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID-19.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

**VENDIM****Nr. 57, datë 7.10.2020****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR OPERACIONALIZIMIN E
INSTRUMENTIT TË RIKAPITALIZIMIT
NGA BRENDA DHE RASTEVE
PËRJASHTIMORE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe të nenit 31, pika 7, dhe nenit 87, të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”; me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për operacionalizimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda dhe rasteve përjashtimore” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, me zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gent Sejko****RREGULLORE****PËR OPERACIONALIZIMIN E
INSTRUMENTIT TË RIKAPITALIZIMIT
NGA BRENDA DHE RASTEVE
PËRJASHTIMORE****Neni 1****Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve që Banka e Shqipërisë merr në konsideratë në ushtrimin e kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit të detyrimeve dhe instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, si dhe i rasteve përjashtimore nga ushtrimi i kësaj kompetence.

Neni 2**Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3**Baza ligjore**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) nenit 31, pika 7 dhe nenit 87, të ligjit nr. 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në Banka, në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4**Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar ose të përdorur në:

a) ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vijim ligji për bankat;

c) ligjin nr. 133/2016, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, në vijim ligji nr. 133/2016;

d) rregulloren nr. 44, datë 5.6.2019, “Vlerësimi për qëllime të ndërhyrjes së



jashtëzakonshme”, në vijim rregullorja “Vlerësimi për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, për qëllime të zbatimit, në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “efekti zinxhir i drejtpërdrejtë” nënkupton situatën kur zhvlerësimi ose konvertimi i detyrimeve të bankës në kapital, shkakton humbje të drejtpërdrejta për kundërpalën përkatëse, që mund të çojë në të ardhmen e afërt në një situatë paafësie paguese të saj;

b) “efekti zinxhir i tërthortë” nënkupton situatën kur zhvlerësimi ose konvertimi i detyrimeve të bankës në kapital, shkakton efekt negativ në pjesëmarrësit në treg që mund të çojë në ndërprerje të rëndë të veprimtarisë/funksionimit të sistemit financiar dhe dëme të mëdha në ekonomi.

Neni 5

Kërkesa të përgjithshme

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson, rast pas rasti dhe në mënyrë specifike për secilën bankë, detyrimet që mund të përjashtohen nga ushtrimi i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda përmes zhvlerësimit dhe konvertimit të detyrimeve në kapital, sipas nenit 31, pika 4, të ligjit nr. 133/2016.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet kur konsideron detyrimin që mund të përjashtohet sipas nenit 31, pika 4, të ligjit nr. 133/2016 dhe përpara përjashtimit të plotë të tij, kur është e mundur dhe aq sa është e mundur, vlerëson mundësinë për përjashtimin e pjesshëm të detyrimit, duke kufizuar madhësinë e zhvlerësimit të tij.

3. Përjashtimi i detyrimit nga zbatimi i rikapitalizimit nga brenda sipas nenit 31, pika 4, të ligjit nr. 133/2016, bazohet në plotësimin e të paktën një prej objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të përcaktuar në nenin 20, pika 2, të ligjit nr. 133/2016.

4. Në rast se përjashtimi i detyrimit nënkupton përdorimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme argumenton nevojën për përjashtim, duke marrë në konsideratë rrethanat specifike të rastit.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rast se vlerëson se do të përjashtojë plotësisht ose pjesërisht detyrimin në përputhje me nenin 31, pika 4, të ligjit nr. 133/2016, dhe ky përjashtim përfshin përdorimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, argumenton:

a) rrethanat e jashtëzakonshme, të ndryshme nga rrethanat e parashikuara gjatë hartimit të planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të cilat përcaktojnë se detyrimi duhet të përjashtohet nga rikapitalizimi nga brenda gjatë vendosjes së bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme;

b) arsyet pse nuk mund të parashikoheshin këto rrethana të jashtëzakonshme gjatë hartimit të planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe argumentimin e nevojës për përjashtimin e detyrimit;

c) masat e ndërmarra nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për heqjen e pengesës ndaj ndërhyrjes së jashtëzakonshme, nëse nevoja për përjashtimin e detyrimit është parashikuar në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

6. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet kur vlerëson nëse do të përjashtojë plotësisht ose pjesërisht detyrimin sipas nenit 31, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 133/2016 dhe ky përjashtim përfshin përdorimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, argumenton:

a) nëse përmbushen dhe si përmbushen kushtet e përcaktuara në nenet 6 dhe 7 në këtë rregullore;

b) arsyen pse nevoja për përjashtim nuk mund të trajtohej nga një metodë e përshtatshme vlerësimi e kryer në përputhje me nenin 24 të ligjit nr.133/2016.

7. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet kur vlerëson nëse do të përjashtojë plotësisht ose pjesërisht detyrimin për ruajtjen e vazhdimësisë së funksioneve kritike dhe të veprimtarive kryesore të bankës, sipas nenit 31, pika 4, shkronja “b”, të ligjit nr.133/2016 dhe ky përjashtim përfshin përdorimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, argumenton:

a) nëse përmbushen dhe si përmbushen kërkesat e përcaktuara në nenin 8 në këtë rregullore;

b) arsyen pse detyrimi që përjashtohet është më i rëndësishëm për vazhdueshmërinë e



funksioneve kritike ose të veprimtarive kryesore të bankës, sesa detyrimet që nuk përjashtohen.

8. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet kur vlerëson nëse do të përjashtojë plotësisht ose pjesërisht detyrimin për të shmangur impaktin negativ mbi stabilitetin e sistemit financiar sipas nenit 31, pika 4, shkronja “c”, të ligjit nr. 133/2016 dhe ky përjashtim përfshin përdorimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, argumenton:

a) nëse përmbushen dhe si përmbushen kërkesat e përcaktuara në nenin 9 në këtë rregullore;

b) arsyen pse detyrimi që përjashtohet mund të shkaktojë impakt negativ mbi stabilitetin e sistemit financiar, në krahasim me detyrimet që nuk përjashtohen.

9. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet kur vlerëson nëse do të përjashtojë plotësisht ose pjesërisht detyrimin sipas nenit 31, pika 4, shkronja “ç”, dhe ky përjashtim përfshin përdorimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, argumenton si përmbushen dhe nëse përmbushen kushtet e përcaktuara në nenin 10, të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Përjashtimi në kushtet kur detyrimi nuk mund të zhvlerësohet ose të konvertohet në kapital brenda një kohe të arsyeshme

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të përjashtojë detyrimin nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda, kur pengesat për zbatimin e këtij instrumenti nuk mundësojnë ushtrimin e tij brenda një kohe të arsyeshme, pavarësisht përpjekjeve më të mira të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

2. Në zbatim të pikës 1, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme:

a) përshkruan në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme proceset që garantojnë sigurimin brenda një kohe të arsyeshme të informacionit që kërkohet për vlerësimin për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme sipas nenit 24, të ligjit nr. 133/2016;

b) merr masa për heqjen e pengesave potenciale ndaj aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme ku përfshihen rrethanat që mund të çojnë në përjashtimin potencial të

detyrimit, të cilat mund të parashikohen në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në rast se ky përjashtim potencial përbën pengesë ndaj aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Neni 7

Kushtet për përcaktimin e kohës së arsyeshme për zhvlerësimin dhe konvertimin e detyrimit në kapital

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton kohën e arsyeshme për zhvlerësimin dhe konvertimin e detyrimit në kapital, sipas nenit 31, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 133/2016, bazuar në kohën kur duhet të:

a) përcaktohet përfundimisht madhësia e zhvlerësimit të detyrimit;

b) zbatohen hapat e nevojshëm për të zbatuar instrumentin e rikapitalizimit ndaj detyrimit përkatës, me qëllim plotësimin e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke marrë në konsideratë rrethanat në kohën e zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2. Në zbatim të pikës 1, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson:

a) nevojën për të publikuar vendimin për ushtrimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda dhe përcaktimin e madhësisë së rikapitalizimit dhe shpërndarjes përfundimtare të saj, sipas klasave të ndryshme të kreditorëve;

b) pasojat që ka vonesa e vendimit për publikim sipas shkronjës “a” më lart, në besimin e tregut dhe në reagimin potencial të tij (p.sh. në terma të tërheqjes së likuiditetit), si dhe në efektivitetin e veprimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke marrë në konsideratë sa më poshtë:

i. nëse situata financiare ose mundësia për paaftësi paguese në bankë tashmë njihet nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut,

ii. nëse njihen në treg pasojat e situatës financiare ose të mundësisë për paaftësi paguese të bankës mbi pjesëmarrësit e tjerë të tregut;

c) kohën e hapjes së tregjeve për të vlerësuar ndikimin që mund të ketë në funksionet kritike dhe efektin zinxhir;

d) datën referencë kur duhet të përmbushen kërkesat për kapital;

e) datat kur duhet të kryhen pagesat e bankës dhe maturiteti i detyrimeve përkatëse;



f) tërësinë dhe kompleksitetin e proceseve/hapave/masave që duhen ndjekur për të siguruar ushtrimin e kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit ndaj detyrimit përkatës.

Neni 8

Përfshirja për ruajtjen e vazhdimësisë së funksioneve kritike dhe të veprimtarive kryesore të bankës

1. Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme mund të përfshijë detyrimin, me qëllim ruajtjen e vazhdimësisë së funksioneve kritike të bankës, kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) ushtrimi i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda mbi detyrimin mund të cenojë vazhdimësinë e funksionit kritik të bankës, për shkak të financimit të tij përmes këtij detyrimi ose të varësisë së kryerjes së këtij funksioni nga kundërpala përkatëse, nga infrastruktura ose ofruesi i shërbimit, të cilët mund të pengojnë ose të mos jenë të gatshëm të zhvillojnë transaksione me bankën, pas zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda;

b) funksioni kritik është një shërbim i ofruar nga banka për palët e treta, të cilat varen nga ushtrimi i pandërprerë i këtij funksioni.

2. Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme mund të përfshijë detyrimet e nevojshme për administrimin e rrezikut për mbrojtjen (*hedge*) në kuadër të funksioneve kritike, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) administrimi i rrezikut për mbrojtjen (*hedge*) njihet për qëllime prudenciale dhe është i nevojshëm për ushtrimin e operacioneve që lidhen me funksionet kritike;

b) banka nuk mund të zëvendësojë administrimin e rrezikut për mbrojtjen (*hedge*) me kundërpalë të tjera, në terma të arsyeshëm financiarë dhe brenda kohës së nevojshme për ruajtjen e vazhdimësisë së funksioneve kritike.

3. Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme mund të përfshijë detyrimet për qëllime të ruajtjes së marrëdhënieve të financimit, kur plotësohet kushtet e mëposhtme:

a) financimi përmes këtyre detyrimeve është i rëndësishëm për ruajtjen e vazhdimësisë së funksioneve kritike të bankës;

b) banka nuk mund të zëvendësojë marrëdhënien e financimit brenda kohës së nevojshme që siguron ruajtjen e vazhdimësisë së funksioneve kritike.

4. Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme mund të përfshijë detyrimin, me qëllim ruajtjen e vazhdimësisë së veprimtarive kryesore të bankës, kur përfshirja është e rëndësishme për ruajtjen e aftësisë së bankës në ndërhijrje të jashtëzakonshme për ofrimin e operacioneve, shërbimeve dhe transaksioneve kryesore dhe për përmbushjen e objektivave të ndërhijres së jashtëzakonshme sipas nenit 20, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 133/2016.

Neni 9

Përfshirja për shmangien e impaktit negativ mbi stabilitetin financiar

1. Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme, në rastet kur merr në konsideratë përfshirimin e detyrimit sipas nenit 31, pika 4, shkronja “c”, të ligjit nr. 133/2016, bazuar në efektin zinxhir të drejtpërdrejtë, vlerëson aq sa është e mundur, ndërvarësinë e bankës në ndërhijrje të jashtëzakonshme me kundërpalën përkatëse. Ky vlerësim përfshin sa në vijim:

a) ekspozimin me kundërpalën përkatëse në lidhje me rrezikun që zbatimi i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda mbi këtë detyrim mund të shkaktojë paaftësi paguese të kundërpalës;

b) rëndësinë sistematike të kundërpalës që mund të shkojë në paaftësi paguese, në veçanti në lidhje me pjesëmarrësit e tjerë të tregut financiar dhe ofruesit e infrastrukturës së tregjeve financiare.

2. Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme, në rastet kur merr në konsideratë përfshirimin e detyrimit sipas nenit 31, pika 4, shkronja “c”, të ligjit nr. 133/2016, bazuar në efektin zinxhir të tërthortë, vlerëson aq sa është e mundur nevojën për këtë përfshirje, në bazë të treguesve të ndryshëm objektivë. Treguesit që mund të shqyrtohen në këtë rast përfshijnë:

a) numrin, madhësinë dhe ndërvarësinë e bankave me karakteristika të ngjashme me bankën në ndërhijrje të jashtëzakonshme, në nivelin që mund të shkaktojë humbje besimi të



gjerë në sektorin bankar ose në sistemin financiar;

b) numrin e klientëve të bankës që ndikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga zbatimi i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda dhe ndikimi që ka komunikimi publik i vendimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në humbjen e besimit të gjerë në sektorin bankar ose në sistemin financiar;

c) numrin, madhësinë dhe ndërvlerësinë e kundërpartive që ndikohen nga rikapitalizimi, përfshirë pjesëmarrësit në treg nga sektori financiar jobankar, si dhe rëndësinë e funksioneve kritike që ofrohen nga këto kundërpalë;

d) aftësinë e kundërpalëve për të aksesuar ofrues alternativë të shërbimit për funksionet që janë vlerësuar si të zëvendësueshme, në përputhje me situatën specifike;

e) mundësinë që pas rikapitalizimit, një numër i konsiderueshëm kundërpalësh të tërheqin financimin ose të ndërpresin transaksionet me bankat e tjera, ose mundësinë për mosfunksionim të duhur të tregjeve, si pasojë e ushtrimit të instrumentit të rikapitalizimit mbi pjesëmarrësit në këto tregje, në veçanti në rast të humbjes së përgjithshme të besimit;

f) tërheqje masive të financimit afatshkurtër ose të depozitave në banka;

g) numrin, madhësinë dhe rëndësinë e bankave që janë në rrezik për të plotësuar kushtet për ndërhyrje të hershme ose pranë një situatë paafësie paguese sipas nenit 21, pika 2, të ligjit nr. 133/2016;

h) rrezikun për ndërprerje të ndjeshme të funksioneve kritike ose rritje të ndjeshme të çmimeve për ofrimin e këtyre funksioneve (sipas ndryshimeve në kushtet e tregut për këto funksione ose disponueshmërisë së tyre) ose pritshmëritë përkatëse për këtë rrezik, nga kundërpalët dhe pjesëmarrësit e tjerë në treg;

i) ndërprerje e rëndësishme e funksionimit të tregut ndërbankar, për shkak të rritjes së ndjeshme të kostos së financimit dhe uljes së vlerës së kolateralit në dispozicion të këtyre bankave;

j) ndërprerje të rëndësishme të funksionimit të tregut ndërbankar, siç vërehet nga një rritje e ndjeshme e marzhit të kërkuar nga kundërpalët dhe zvogëlim i vlerës së kolateralit.

Neni 10

Përjashtimi për shkak të humbjes së vlerës

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, kur merr në konsideratë përjashtimin e detyrimit sipas nenit 31, pika 4, shkronja “ç”, të ligjit nr. 133/2016, krahason dhe vlerëson ndikimin në kreditorët e bankës sipas skenarëve të zbatimit dhe moszbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda.

2. Për qëllime të kryerjes së vlerësimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, zbatohen kërkesat dhe kriteret e parashikuara në rregulloren “Vlerësimi për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

VENDIM Nr. 58, datë 7.10.2020

PËR PËRJASHTIMIN NGA MBAJTJA E KOMISIONEVE PËR LLOGARITË E HAPURA NË SISTEMET E PAGESAVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË, PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 73, të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”; si dhe nenit 50, pika 3, të rregullores nr. 76, datë 18.12.2014, “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)”, të ndryshuar; me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Përjashtimin nga mbajtja e të gjitha komisioneve për të gjitha llogaritë e hapura në sistemet e pagesave AFISaR të Bankës së Shqipërisë, për administrimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.



3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 424, datë 12.10.2020

PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE DHE KRITEREVE LIGJORE TË REKRUTIMIT TË KANDIDATIT PËR KANCELAR, PËR KËSHILLTAR OSE PËR NDIHMËSLIGJOR

Në mbështetje të nenit 147/a, pika 1, shkronja “d”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 90 dhe 97, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 53, 55 dhe 83, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 165, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 6, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Këshilli i Lartë Gjyqësor

VENDOSI:

I. QËLLIMI, OBJEKTI DHE SUBJEKTET

1. Qëllimi i vendimit është përcaktimi i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmësligjor në gjykatat e apelit, si dhe të pasurisë dhe të figurës së tij, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të parimeve të përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe

mosdiskriminimit, mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror dhe të proporcionalitetit, për zbatimin e unifikuar të standardeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Ky vendim rregullon procedurat e verifikimit:

a) të kushteve dhe kriterëve ligjore:

i. për kandidatin për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmësligjor në gjykatat e apelit;

ii. për kandidatin fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmësligjor në gjykatat e apelit;

iii. për kandidatin për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmësligjor në gjykatat e apelit;

iv. për kancelarin në detyrë, këshilltarin ligjor në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe ndihmësligjorin në detyrë në gjykatat administrative;

b) të pasurisë dhe figurës së kandidatëve sipas nënparagrafëve “ii” dhe “iv”, shkronja “a”, të kësaj pike.

II. KUADRI LIGJOR

3. Ky vendim do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me:

a) Kodin e Procedurave Administrative;

b) ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;

c) ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;

ç) ligjin nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

d) ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

dh) ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

e) ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;

ë) ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;



f) ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;

g) ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

gj) ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

III. PËRKUFIZIME

4. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Ekspert” nënkupton specialistin e punësuar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, i licencuar në një fushë të caktuar ose specialistin e licencuar në një fushë të caktuar, i përzgjedhur nga listat e përditësuara të subjekteve të licencuar për fushën përkatëse nga organi kompetent sipas ligjit ose ndërmjet atyre që e ushtrojnë veprimtarinë në institucione të specializuara.

b) Formulari “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” është deklarata tip e miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

c) Formulari “Deklaratë e kontrollit të pasurive dhe të konfliktit të interesit” është deklarata sipas nenit 6, pika 2, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

ç) Formulari “Deklaratë e kontrollit të figurës” është deklarata sipas nenit 6, pika 3, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe shtojcës A, të këtij ligji.

d) Formularë “Vetëdeklarimi” janë deklaratat sipas nenit 6, pika 4, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe shtojcës B, të këtij ligji.

dh) “Kandidat” nënkupton personin që përfshihet në një prej kategorive të subjekteve të përcaktuara në shkronjën “a”, pika 2, kreu I, të këtij vendimi.

e) “Këshill” është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

ë) “Komision i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve” është

Komisioni i ngritur sipas ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

f) “Komisioni i Përkohshëm” nënkupton komisionin e krijuar sipas pikës 14, të nenit 62, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;

g) “Organe të rivlerësimi kalimtar” janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit, të krijuara sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

gj) “Procedurë verifikimi” nënkupton procesin administrativ të verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale të kandidimit, si dhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, të subjekteve të përcaktuara në pikën 2, kreu I, të këtij vendimi.

h) “Relator” nënkupton anëtarin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit i ngarkuar për të realizuar një procedurë verifikimi.

i) “Vendim verifikimi” nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për verifikimin e kushteve dhe kriterëve formale të kandidimit, si dhe për verifikimin e pasurisë dhe figurës, për subjektet e përcaktuara në pikën 2, kreu I, të këtij vendimi.

IV. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR VERIFIKIMIN E KANDIDATËVE

A. Objekti i verifikimit sipas kategorisë së kandidatëve

5. Kandidatët për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për kancelarë, për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë ose për ndihmësligjorë në gjykatat e apelit, i nënshtrohen verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale të pranimit në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

6. Kandidatët fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për kancelarë, për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë ose për ndihmësligjorë në gjykatat e apelit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe figurës.

7. Kandidatët për kancelarë, për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë ose për ndihmësligjorë në gjykatat e apelit, që kanë



përfunduar programin respektiv të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

8. Kancelarët në detyrë i nënshtrohen verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, si dhe të pasurisë dhe figurës.

9. Këshilltarët ligjorë në detyrë në Gjykatën e Lartë i nënshtrohen verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, atij të konfirmimit në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar.

10. Ndihmësligjorët në detyrë në gjykatat administrative i nënshtrohen verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, përfshirë dhe atij të konfirmimit në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar.

B. Fazat e procedurës së verifikimit

11. Procedura e verifikimit, sipas rastit, kalon në këto faza:

a) fillimi i procedurës së verifikimit nga Këshilli;

b) veprimet procedurale paraprake dhe verifikuese, sipas rastit, të relatorit të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ose të Komisionit të Përkohshëm;

c) shqyrtimi nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit i procedurës së verifikimit të realizuar nga relatori;

ç) shqyrtimi nga Këshilli i procedurës së verifikimit dhe projektitaktit të verifikimit përgatitur nga relatori Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ose Komisioni i Përkohshëm.

C. Organet e verifikimit

C.1 Relatori

12. Relatori në një procedurë verifikimi caktohet me short, ndërmjet anëtarëve të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

13. Për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi kërkesë të çdo anëtari të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti. Me propozimin e Komisionit, Këshilli mund të vendosë që në procedurat e shortit për caktimin

e relatorit, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit.

14. Relatori kujdeset për verifikimin e plotësimit nga kandidati të kriterëve ligjorë të kandidimit dhe në veçanti për:

a) administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të nevojshëm të verifikimit;

b) përgatitjen e relacionit, ku përshkruhen veprimet e kryera dhe dokumentet e administruara gjatë verifikimit, si dhe një përmbledhje faktike të tyre për atë që është e nevojshme për qëllimin e verifikimit, duke i bashkëlidhur relacionit kopje të këtyre dokumenteve;

c) përgatitjen e projektvendimit përkatës të verifikimit;

ç) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;

d) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;

dh) njoftimet për kandidatin.

15. Krahas veprimeve procedurale dhe verifikuese të tjera që i vlerëson të nevojshme rast pas rasti, relatori, në varësi të procesit konkret të kandidimit, realizon procedurat standarde si më poshtë:

a) i dërgon kandidatin, në rrugë elektronike, formularët e deklaramentit dhe vetëdeklarimit;

b) i dërgon kandidatin, në rrugë elektronike, formularin autorizues për dhënien e miratimit për përpunimin e të dhënave personale dhe merr në dorëzim fizikisht, të nënshkruar nga kandidati, këtë formular;

c) i dërgon kandidatin, në rrugë elektronike, formularin autorizues për verifikimin, pranë çdo subjekti publik dhe privat, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave që lidhen me kriteret ligjorë të kandidimit dhe merr në dorëzim fizikisht, të nënshkruar nga kandidati, këtë formular;

ç) dërgon shkresat standarde për kërkimin e informacionit nga subjektet publike dhe private, si dhe të shpjegimeve përkatëse nga kandidati, në lidhje me kushtet dhe kriteret ligjorë të kandidimit.

16. Relatori, kur konstaton dhe vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga kandidati është i paplotë, njofton menjëherë atë për plotësimin e tij sipas ligjit, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë. Mbi kërkesën e kandidatin, kur i



vlerëson të justifikuara motivet e paraqitura për mos përmbushjen në afatin e caktuar të detyrimit për plotësimin e dokumentacionit, relatori i cakton atij një afat të ri të arsyeshëm.

17. Bazuar në gjetjet e verifikimit, nëse vlerëson që mund të procedohet me skualifikimin e kandidatit, pasi vë në dijeni Komisionin, me vendim të këtij të fundit, relatori njofton kandidatin lidhur me gjetjet paraprake dhe dokumentacionin përkatës, si edhe për të drejtën që, brenda një afati 5-ditor nga dita e njoftimit, të paraqesë në rrugë elektronike dhe/ose në zyrën përkatëse të Këshillit, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij. Në këtë rast, në pamundësi objektive ose për motive të tjera të justifikuara për të paraqitur qëndrimin dhe shpjegimet brenda afatit 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin, duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Nëse motivet vlerësohen të justifikuara, mbi kërkesën e kandidatit, relatori i cakton atij një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur qëndrimet dhe shpjegimet lidhur me gjetjet e verifikimit.

18. Në përfundim të verifikimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm, duke e dërguar çështjen menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.

19. Në ushtrimin e përgjegjësisë së tij, relatori ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit.

C.2 Komisioni

20. Procedura e verifikimit të kandidatëve për në provimin e pranimit për në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmë ligjor në gjykatat e apelit, kryhet nga Komisioni i Përkohshëm, që krijohet në janar të çdo viti, pas përcaktimit nga Këshilli të numrin të kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës për atë vit akademik.

21. Procedurat e tjera të verifikimit të kandidatëve, të ndryshme nga ajo sipas pikës 20,

të këtij vendimi, kryhen nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

22. Komisioni i Përkohshëm mbledhet menjëherë pas përgatitjes së çështjes për shqyrtim nga të tre anëtarët e tij, të cilët janë bashkërelatorë të çështjes. Komisioni vendos për organizimin e punës mes anëtarëve të tij, si dhe për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill.

23. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit mbledhet nga Kryetari i tij, pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim.

24. Në mbledhjen e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatori paraqet përmbledhjen e veprimeve procedurale dhe verifikuese të kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë verifikimit.

25. Komisioni të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, pasi dëgjon relatorin, nëse vlerëson që verifikimi dhe dokumentacioni përkatës është i paplotë, i kërkon relatorit plotësimin e verifikimit ose të dokumentacionit të nevojshëm, duke evidentuar sipas rastit veprimet verifikuese dhe/ose dokumentacionin, për të cilët lind nevoja e plotësimit apo saktësimit. Në rast të kundërt, Komisioni vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill.

26. Komisioni i Përkohshëm dhe Komisioni i Planifikimit Strategjik, vendosin me shumicë votash.

C.3 Këshilli

27. Këshilli mbledhet nga Kryetari i tij, pas njoftimit për çështjen e përgatitur për shqyrtim, respektivisht nga Kryetari i Komisionit të Përkohshëm ose nga relatori i Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

28. Në mbledhjen e Këshillit, sipas rastit, Kryetari i Komisionit të Përkohshëm apo një anëtar i tij, ose relatori i Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, parashtron përmbledhjen e veprimeve të kryera, faktet që kanë rezultuar gjatë verifikimit, si dhe jep sqarime për pyetje të anëtarëve të Këshillit.

29. Kur Këshilli vlerëson se verifikimi nuk është i plotë, cakton një mbledhje tjetër për shqyrtimin e çështjes. Në këtë rast, Këshilli



evidenton mangësitë që duhen plotësuar. Në mbledhjen tjetër, Këshilli i bëhet e ditur plotësimi i mangësive të konstatuara.

30. Pas bisedimeve, Këshilli vendos për miratimin e projektvendimit të verifikimit sikundër ai është propozuar, respektivisht, nga Komisioni i Përkohshëm ose nga relatori i Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, apo me ndryshime, sipas propozimit të çdo anëtar. Në përfundim të votimit, Kryetari deklaron rezultatin e votimit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

Ç. Të drejtat e kandidatit

31. Kandidati njoftohet menjëherë për fillimin e procedurës së verifikimit dhe, kur është rasti, për relatorin.

32. Kandidati ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e relatorit për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, jo më vonë se 3 ditë, nga marrja e dijeni e shkakut të përjashtimit, duke shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Këtë të drejtë kandidati e ka edhe ndaj çdo anëtar tjetër të Këshillit.

33. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e relatorit dhe/ose të çdo anëtar të Këshillit, jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e saj.

34. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së verifikimit, me kërkesë, të njihet me dokumentet e dosjes së tij, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative.

35. Kryesisht, apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për fakte, rrethana apo çështje ligjore që lidhen me kriteret me kandidimin të tij, si dhe të depozitojë, kur është rasti, dokumente shkresore në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

36. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e verifikimit, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim.

D. Afatet dhe llogaritja e tyre

37. Afatet në procedurën e verifikimit caktohen në ditë, në javë ose në muaj. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike.

38. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

39. Afati i përcaktuar në javë mbaron me kalimin e asaj dite, që është e njëjta me ditën, në të cilën ka ndodhur ngjarja, nga e cila ka filluar të ecë afati.

40. Afati i përcaktuar në muaj mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

41. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

42. Dita e fundit e afatit vazhdon deri në orën 24.00 të saj.

DH. Njoftimet

43. Njoftimet dhe kërkesat e Këshillit drejtuar kandidatit dhe anasjelltas, si rregull bëhen në rrugë elektronike. Ato konsiderohen të marra ditën e nesërme të dërgimit në rrugë elektronike.

44. Adresa elektronike e Këshillit i bëhet e ditur kandidatit me njoftimin e fillimit të procedurës së verifikimit.

45. Adresë elektronike e kandidatit është ajo e deklaruar nga ai për këtë qëllim pranë Këshillit. Për kancelarin në detyrë adresë elektronike e kandidatit konsiderohet adresa zyrtare e tij, por ai mund të zgjedhë një adresë tjetër elektronike, duke ia bërë atë të ditur në kohë Këshillit. Kandidati merr masa për aksesueshmërinë e adresës së tij elektronike.

E. Dorëheqja dhe përjashtimi për shkak të konfliktit të interesit

46. Relatori, anëtar i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, në çdo kohë kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore sipas neneve 72, 73, 74 dhe 75, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e verifikimit të kandidatit.

47. Për dorëheqjen e çdo anëtar të Këshillit vendos Kryetari i tij. Kur dorëheqjen e jep



Kryetari i Këshillit, vendimi merret nga Zëvendëskryetari i tij.

48. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e një anëtarit të tij.

49. Për nëpunësit e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve dhe personelin administrativ të Këshillit zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” mbi paanësinë e administratës publike.

V. PROCEDURA E VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE PËR NË PROVIMIN E PRANIMIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

50. Kushtet/kriteret e përgjithshme të pranimit në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmësligjor në gjykatat e apelit, përcaktohen në nenin 55, pika 1, të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me nenin 21, të ligjit “Për nëpunësin civil”. Kandidati duhet:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

51. Kriteret e veçanta të pranimit në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar për kancelar në Shkollën e Magjistraturës, përcaktohen në pikën 1, të nenit 56, të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Kandidati duhet:

- a) të jenë diplomuar në drejtësi ose ekonomi në nivelin “Master shkencor” ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë.
- b) të kenë përvojë profesionale mbi tetë vjet, nga të cilat së paku tre vjet në pozicione administruese ose pesë vjet në sistemin gjyqësor.

52. Kriteret e veçanta të pranimit në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar për ndihmësligjor në gjykatat e apelit, në Shkollën e Magjistraturës, përcaktohen në pikën 2, të nenit 56, të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Kandidati duhet:

- a) të jenë diplomuar në drejtësi në nivelin “Master shkencor”, të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;
- b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë së paku tre vjet përvojë pune profesionale që lidhet me gjykatën.

53. Kriteret e veçanta të pranimit në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, në Shkollën e Magjistraturës, përcaktohen në pikën 3, të nenit 56, në lidhje me pikën 6, të nenit 34, të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Kandidati duhet:

- a) të jetë diplomuar në drejtësi në nivelin “Master shkencor”, të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;
- b) përvojë profesionale jo më pak se 10 vjet si nëpunës i lartë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare;
- c) njohuri në jurisprudencën e gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare;
- ç) njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të vendeve të Bashkimit Evropian;
- d) aftësi të shkrimit dhe arsytimit ligjor;
- dh) të mos ketë masa disiplinore në fuqi në pozicionet e mëparshme;
- e) të jetë autor i artikujve dhe botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës.

54. Procedura e verifikimit fillon jo më vonë se 7 ditë nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të listës së kandidatëve që kanë kandiduar për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelarë, për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmësligjorë në gjykatat e apelit, si dhe të dokumentacionit mbështetës të paraqitur prej tyre.

55. Kandidatët njoftohen për fillimin e procedurës së verifikimit nga Komisioni i



Përkohshëm nëpërmjet një njoftimi publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

56. Verifikimi kryhet mbi bazën e dokumenteve të paraqitura nga kandidati në momentin e kandidimit. Dokumenti që nuk është në formën e kërkuar nga ligji, që nuk përmban të dhëna të plota, që përmban pasaktësi ose elementë që sjellin dyshime për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij, nuk merret parasysh për qëllimin e verifikimit. Përfundimisht, Komisioni mund të kërkojë nga kandidati plotësimin e dokumentit që mbart mangësi.

57. Në përfundim të verifikimit, Komisioni i Përkohshëm përgatit:

a) një relacion, ku përshkruhen të dhënat që rezultojnë për çdo kandidat, në lidhje me plotësimin ose jo të kushteve dhe kriterëve formale të kandidimit, duke i bashkëlidhur listat për çdo kategori;

b) projektvendimin përkatës të verifikimit.

58. Kryetari i Komisionit të Përkohshëm njofton Kryetarin e Këshillit, për përgatitjen e çështjes.

59. Këshilli vendos për miratimin e projektvendimit të verifikimit të kandidatëve sikundër ai është propozuar nga Komisioni i Përkohshëm apo me ndryshime, sipas propozimit të çdo anëtari.

VI. PROCEDURA E VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE FITUES NË PROVIMIN E PRANIMIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

A. Rregulla të përgjithshme

60. Kandidati fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmësligjor në gjykatat e apelit, i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe figurës.

61. Procedura e verifikimit fillon me vendim të Këshillit, jo më vonë se 7 ditë nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të listës së kandidatëve fitues në provimin e pranimit për në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmësligjor në gjykatat e apelit.

62. Në të njëjtin vendim për fillimin e verifikimit, Këshilli cakton, me short, relatorin për çdo kandidat.

63. Përfundimisht, për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi kërkesë të çdo anëtari të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti. Me propozimin e Komisionit, Këshilli mund të vendosë që në procedurat e shortit për caktimin e relatorit, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit.

64. Pas caktimit të relatorit, kandidati njoftohet për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, për relatorin e procedurës, si dhe për të drejtën që ka për të kërkuar përjashtimin e tij dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, jo më vonë se 3 ditë nga njoftimi ose nga marrja e dijeni e shkakut të përjashtimit, duke shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Në këtë rast, kandidati i dërgohet dhe formulari deklarues për adresën elektronike për qëllimet e procedurës së verifikimit, të cilin duhet ta dorëzojë brenda 3 ditëve në zyrën e posaçme të Këshillit.

B. Verifikimi i pasurisë

65. Jo më vonë se 3 ditë, nga ajo e njoftimit për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidati i dërgohen, në rrugë elektronike, formulari “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”, si edhe informacioni mbi lidhjen elektronike zyrtare të ILDKPKI-së, në të cilën kandidati mund të marrë dhe plotësojë në rrugë elektronike këtë Deklaratë, përfshirë udhëzimin përkatës për mënyrën e plotësimit të saj.

66. Njëkohësisht, kandidati i dërgohen, në rrugë elektronike, edhe formularët autorizues për Këshillin, përmes të cilëve i japin atij të drejtën për të kryer verifikime dhe për të kërkuar raportim, informacion dhe dokumentacion, nga institucioni kompetent për verifikimin e pasurisë, ILDKPKI-ja, si dhe nga organet publike financiare (të administratës tatimore dhe doganore) apo çdo subjekt tjetër publik dhe privat, në lidhje me të dhëna mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit



dhe personave të lidhur. Autorizimet, të nënshkruara rregullisht nga kandidati dhe personat e lidhur, depozitohen pranë zyrës së posaçme të Këshillit, jo më vonë se 3 ditë nga ajo e marrjes në dorëzim.

67. Jo më vonë se 3 ditë nga ajo e nënshkrimit dhe dorëzimit nga kandidatët dhe personat e lidhur të autorizimeve sipas pikës 65, të këtij vendimi:

a) Këshilli i dërgon ILDKPKI-së listën e kandidatëve që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë, si dhe i kërkon njoftimin menjëherë për çdo kandidat që nuk dorëzon, brenda afatit, formularin e deklarimit të pasurisë;

b) relatori fillon procedurat për kryerjen e veprimeve të kërkit, nga organet e administratës tatimore dhe doganore, të të dhënave me karakter pasuror në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur. Gjatë procedurës së verifikimit, në varësi të informacioneve të marra, relatori mund të kërkojë të dhëna edhe nga çdo subjekt tjetër publik ose privat që identifikohet se mund të zotërojë të dhëna të kësaj natyre.

68. Jo më vonë se dy javë nga dërgimi, në rrugë elektronike, i formularit të deklarimit të pasurisë, kandidati e dorëzon atë të plotësuar pranë ILDKPKI-së. Deklarimi bëhet sipas përcaktimeve të neneve 3/1, 4, pika 2 e vijues të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

69. Verifikimi i pasurisë së kandidatit mbështetet në raportin e kontrollit të plotë të ILDKPKI-së, për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatit, kontroll i cili, sipas ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, kryhet jo më vonë se 2 muaj nga dorëzimi i deklaratës së pasurisë.

70. Në rastin kur ILDKPKI-ja vlerëson se nuk është vendi për rikontroll të plotë sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 25/1, të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, verifikimi i pasurisë së kandidatit mbështetet në kopjen e deklarimit të kandidatit, si edhe gjetjet dhe përfundimet e

nxjerra gjatë procedurës së mëparshme të kontrollit të plotë të deklarimit, dërguar nga ILDKPKI-ja në Këshill. Në çdo rast, Këshilli kryen veprimet e parashikuara nga shkronja “b”, e pikës 67, të këtij vendimi.

71. Pavarësisht parashikimit të pikës 70, të këtij vendimi, nëse pas fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatit, relatori vjen në dijeni, mbi informacionet dhe dokumentacionin e marrë nga burime të ligjshme (nga organet e administratës tatimore dhe doganore apo çdo subjekt tjetër publik ose privat), për rrethana që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklarimin e pasurisë së kandidatit, njofton menjëherë ILDKPKI-në për të ushtruar kompetencën e rikontrollit të plotë të deklarimit të kandidatit sipas parashikimeve neneve 3/1 dhe 25/1, pika 4, të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

72. Në përfundim të verifikimit të kryer sipas ligjit, ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë Këshillit raportin e kontrollit të plotë për pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe personave të lidhur.

73. Kur është rasti, raporti i ILDKPKI-së për kontrollin e plotë të pasurisë, interesave private dhe detyrimeve financiare të kandidatit dhe personave të lidhur, i njoftohet menjëherë kandidatit, duke u ftuar ai për të dhënë sqarime dhe për të paraqitur çdo dokumentacion mbështetës që vlerëson të nevojshëm.

74. Relatori shqyrton rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, si edhe të dhënat mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe personave të lidhur, të dërguara nga subjektet publike ose private sipas kërkesës së Këshillit.

75. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të pasurisë, relatori mund të kërkojë:

a) raport shtesë nga ILDKPKI-ja, nga organet publike financiare, si dhe nga çdo subjekt tjetër publik ose privat;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati.

76. Kur kandidati paraqet shpjegime dhe dokumente mbështetës që kundërshtojnë rezultatet e raportit të ILDKPKI-së, ato i



dërgohen kësaj të fundit, duke iu kërkuar trajtimi i tyre dhe bërja e një raporti shtesë.

77. Pavarësisht parashikimit të pikës 76, të këtij vendimi, nëse gjatë procedurës së verifikimit të pasurisë lind nevoja për njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga shpjegimet e kandidatit, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI-së dhe atyre të sjella nga organet e administratës tatimore dhe doganore, relatori mund të thërrasë ekspert të fushës përkatëse.

78. Kur është rasti, eksperti caktohet nga Komisioni, mbi propozimin e relatorit. Në këtë rast, shpenzimet e ekspertit përballohen nga buxheti i Këshillit.

79. Kandidati njoftohet menjëherë për ekspertin e caktuar nga Këshilli. Jo më vonë se 3 ditë nga marrja dijeni, kandidati njofton Këshillin, duke parashtruar me shkrim edhe motivet konkrete përkatëse, nëse pretendon gjendjen e papajtueshmërisë apo të konfliktit të interesit me ekspertin. Lidhur me pretendimet e kandidatit, Këshilli disponon sipas ligjit.

80. Përpara fillimit të detyrës, eksperti nënshkruan formulën e betimit. Pas veprimt të betimit, sipas udhëzimeve të relatorit, eksperti ka detyrimin të shqyrtojë aktet, të përgatisë, sipas rastit, raport financiar apo mendimin e tij me shkrim, si edhe të ruajë konfidencialitetin e të dhënave që siguron gjatë kryerjes së ekspertimit.

81. Kur e vlerëson, Këshilli mund të thërrasë ekspertin për të dhënë shpjegime në mbledhjen e Këshillit.

C. Verifikimi i figurës

82. Jo më vonë se 3 ditë, nga ajo e njoftimit për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidatit i dërgohet në rrugë elektronike:

a) formulari i vetëdeklarimit sipas ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

b) informacion mbi lidhjen elektronike në faqen zyrtare të Këshillit, në të cilën kandidati mund të marrë dhe plotësojë sipas ligjit, në rrugë elektronike, formularin sipas shkronjës “a”, të kësaj pike;

c) formulari autorizues për Këshillin, përmes të cilit atij i jepet e drejta për të kryer verifikime dhe të kërkuar raportim, informacion dhe dokumentacion nga institucionet kompetente për verifikimin e figurës, Byroja Kombëtare e

Hetimit, shërbimet shtetërore informative, Prokuroria, si dhe nga çdo subjekt tjetër publik ose privat, që mund të disponojë të dhëna mbi figurën e kandidatit.

83. Jo më vonë se 3 ditë nga dërgimi, në rrugë elektronike, i formularëve sipas pikës 82, të këtij vendimi, kandidati i dorëzon ato të plotësuar në zyrën e posaçme të Këshillit.

84. Vetëdeklarimi i kandidatit sipas ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pas verifikimeve të rastit nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit, bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit. Kur është rasti, Kryetari i Këshillit përcjell formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati, në Prokurorinë e Përgjithshme, duke i kërkuar kryerjen e verifikimeve përkatëse.

85. Relatori kryen edhe veprimet për kërkimin e informacionit mbi pengesat ligjore sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 91, të këtij vendimi, nga subjektet e përmendura në këtë seksion.

86. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të figurës dhe integritetit të kandidatit, relatori mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga subjektet e përmendura në këtë seksion;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati.

Ç. Përfundimi i verifikimit

87. Në përfundim të procedurës së verifikimit, në varësi të rezultateve, Këshilli vendos në lidhje me kualifikimin e kandidatit fitues dhe lejjimin e tij për ndjekjen e programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose ndihmësligjor në gjykatat e apelit.

88. Këshilli vendos skualifikimin e kandidatit dhe ndalimin e tij për ndjekjen e programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose ndihmësligjor në gjykatat e apelit, nëse ai nuk kalon verifikimin e pasurisë ose figurës.

89. Skualifikimi i kandidatit sa i përket pasurisë vendoset nga Këshilli, bazuar në rrethanat konkrete dhe respektim të parimit të proporcionalitetit, në rastin kur të dhënat, e marra nga burime të ligjshme, tregojnë se:

a) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;



b) kandidati nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;

c) kandidati ka kryer fshehje të pasurisë;

ç) kandidati ka kryer deklaram të rremë;

d) kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

90. Skualifikimi i kandidatit sa i përket pasurisë vendoset edhe në rastet kur ai:

a) nuk ka plotësuar ose depozituar pranë ILDKPKI-së, formularin e deklaratës së pasurisë;

b) nuk ka depozituar, të nënshkuara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

91. Skualifikimi i kandidatit sa i përket figurës vendoset nga Këshilli në rastet kur nga informacionet dhe raportimet e subjekteve të përmendura në këtë seksion, tregohet se kandidati:

a) ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

b) ka shfaqur sjellje serioze joetike ose mungesë të theksuar integriteti, në atë masë sa nuk garanton besimin e publikut të sistemi i drejtësisë;

c) është në kushtet e ndalimit sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

92. Skualifikimi i kandidatit sa i përket figurës vendoset edhe kur ai:

a) nuk ka plotësuar ose depozituar formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

b) nuk ka depozituar, të nënshkuar, autorizimin për Këshillin, përmes të cilit i jep atij të drejtën për të kryer verifikime dhe të kërkuar raportim, informacion dhe dokumentacion nga subjektet e përmendura në këtë seksion, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij.

VII. PROCEDURA E VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE PËR NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

93. Kandidati për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmësligjor në gjykatat e apelit, që përfundon programin respektiv të formimit fillestar në Shkollën e

Magjistraturës, i nënshtrohet verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

94. Kandidati për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmësligjor në gjykatat e apelit, pranohet në shërbimin civil gjyqësor nëse plotëson kushtin e kalimit me sukses të programit përkatës të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës sipas përcaktimit të pikës 7, të nenit 53, të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

95. Jo më vonë se dy javë nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të listës së kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmësligjor në gjykatat e apelit, mbi propozimin e relatorit të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli vendos në lidhje me kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për secilën kategori.

96. Vendimi i Këshillit mbështetet në listën e kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin përkatës akademik, si dhe në rezultatet e tyre në provimin përfundimtar.

97. Skualifikimi i kandidatit dhe refuzimi për emërim i tij vendoset nga Këshilli në rastin kur ai ka marr më pak se 70 për qind të pikëve totale në provimin përfundimtar të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

VIII. PROCEDURA E VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE PËR NË SHËRBIMET E GJYKATAVE TË POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

98. Kandidati për kancelar në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, ose për ndihmësligjor në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pranohet në shërbimet e gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar nëse plotëson kushtin e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, si dhe kushtet shtesë të sigurisë të përcaktuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Ai i



nënshtrahet sërish verifikimit të pasurisë dhe figurës.

99. Procedura e verifikimit fillon me vendim të Këshillit, jo më vonë se 7 ditë, nga përfundimi i afatit të kandidimit.

100. Në të njëjtin vendim për fillimin e verifikimit, Këshilli, cakton një relator për çdo kandidat.

101. Jo më vonë se 3 ditë, nga ajo e njoftimit për fillimin e procedurës së verifikimit, në rrugë elektronike, kandidati i dërgohen formularët sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si vijon:

a) formulari “Deklaratë e kontrollit të pasurive dhe të konfliktit të interesit”;

b) formulari “Deklaratë e kontrollit të figurës”;

c) formularët e “Vetëdeklarimit”.

102. Njëkohësisht, kandidati i dërgohen, në rrugë elektronike, edhe formularët autorizues për Komisionin e Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve që, në zbatim të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të kryejë verifikimin e pasurisë dhe figurës. Autorizimet, të nënshkruara rregullisht nga kandidati dhe personat e lidhur, depozitohen pranë zyrës së posaçme të Këshillit, jo më vonë se 3 ditë nga ajo e marrjes në dorëzim.

103. Jo më vonë se dy javë nga ajo e nënshkrimit dhe dorëzimit nga kandidati dhe personat e lidhur të formularëve sipas pikës 101, të këtij vendimi, kandidati i dorëzon ato të plotësuar, pranë Këshillit.

104. Jo më vonë se 3 ditë nga dorëzimi i formularëve nga kandidatët, Këshilli ia dërgon ato Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve.

105. Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidati mbështetet në raportin e kontrollit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe mbi pastërtinë e figurës së kandidati, si dhe në çdo dokumentacion tjetër mbështetës të paraqitur nga kandidati apo institucionet shtetërore, kontroll i cili, sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe

krimin e organizuar”, kryhet brenda 120 ditëve nga dërgimi pranë tij i deklaratës së pasurisë.

106. Kur është rasti, raporti i Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe mbi pastërtinë e figurës së kandidati, i njoftohet menjëherë këtij të fundit, duke u ftuar ai për të dhënë sqarime dhe për të paraqitur çdo dokumentacion mbështetës që vlerëson të nevojshëm.

107. Relatori shqyrton rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve.

108. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të pasurisë dhe figurës, relatori mund të kërkojë:

a) raport shtesë nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati.

109. Kur kandidati paraqet shpjegime dhe dokumente mbështetës që kundërshtojnë rezultatet e raportit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, ato i dërgohen këtij të fundit, duke iu kërkuar trajtimi i tyre dhe bërja e një raporti shtesë.

110. Në përfundim të procedurës së verifikimit, në varësi të rezultateve, Këshilli vendos në lidhje me kualifikimin e kandidati dhe vijimin e procedurës së mëtejshme për emërimin, transferimin ose ngritjen në detyrë si kancelar në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, ose si ndihmësligjor në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

111. Skualifikimi i kandidati dhe refuzimi për emërim, transferim ose ngritje në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, vendoset nga Këshilli kur kandidati nuk plotëson kushtet e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, kushtet shtesë të sigurisë të përcaktuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si dhe nuk kalon verifikimin e pasurisë për rastet e përcaktuara në pikat 89 dhe 90, të këtij vendimi, si dhe atë të figurës për rastet e përcaktuara në pikat 91 dhe 92, të këtij vendimi.



IX. VENDIMI I VERIFIKIMIT DHE E DREJTA E ANKIMIT

112. Vendimi i verifikimit arsyetohet sipas kërkesave të nenit 99, të Kodit të Procedurave Administrative lidhur me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ.

113. Vendimi i verifikimit i njoftohet kandidatit sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, i shoqëruar me arsyetimin përkatës.

114. Ndaj vendimit të Këshillit për skualifikimin e kandidatit, ky i fundit mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

115. Në rastin kur Gjykata Administrative e Apelit pranon ankimin e kandidatit dhe cenon vendimin, Këshilli, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

116. Vendimi i Këshillit për përfundimin e procedurës së kandidimit për kandidatin që tërhiqet nga kandidimi, është i paankimueshëm.

X. PUBLIKIMI I VENDIMEVE TË VERIFIKIMIT

117. Vendimet e Këshillit për verifikimin e kandidaturave bëhen publike në faqen zyrtare.

118. Në faqen zyrtare të Këshillit publikohen edhe lista e kandidatëve të kualifikuar dhe ajo e kandidatëve të skualifikuar.

XI. DISPOZITA PËR KANCELARËT, KËSHILLTARËT DHE NDIHMËSLIGJORËT, NË DETYRË

A. Verifikimi, emërimi në shërbimin civil gjyqësor ose ndërprerja e marrëdhënieve të punës, për kancelarët në detyrë

119. Kancelari në detyrë i nënshtrohet verifikimit:

a) të kushteve dhe kriterëve formale të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, si vijon:

i. kushteve/kriterëve të përgjithshme sipas nenit 55, pika 1, të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me nenin 21, të ligjit “Për nëpunësin civil”;

ii. të kriterëve të veçanta sipas nenit 56, pika 1, të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;

b) të pasurisë dhe figurës.

120. Për kancelarin në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, verifikimi i pasurisë dhe figurës kryhet nga Komisioni i Posaçëm i ngritur sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

121. Procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale, të pasurisë dhe figurës, për kancelarët në detyrë, fillon jo më vonë se 7 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

122. Në përfundim të procedurës së verifikimit, në varësi të rezultateve, Këshilli vendos për kualifikimin dhe lejimin e kancelarit në detyrë për të marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës për vlerësimin profesional të tij ose për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në funksionin e kancelarit.

123. Kancelari në detyrë i kualifikuar sipas pikës 122, të këtij vendimi, i cili, pas vlerësimit profesional nga Shkolla e Magjistraturës, arrin të marrë në provim të paktën 70 për qind të pikëve totale, emërohet nga Këshilli në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin që ai mban, brenda një jave nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të rezultateve të provimit.

124. Kancelari në detyrë i kualifikuar sipas pikës 122, të këtij vendimi, i cili, pas vlerësimit profesional nga Shkolla e Magjistraturës, nuk arrin të marrë në provim të paktën 70 për qind të pikëve totale, i ndërpriten marrëdhëniet e punës në funksionin e kancelarit brenda një jave nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të rezultateve të provimit. Në këtë rast, mbi kërkesën e tij, Këshilli vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër në administratën e gjykatës, të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale.

125. Kundër vendimit të Këshillit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në funksionin e kancelarit, mund të paraqitet ankimi, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

B. Verifikimi dhe emërimi në shërbimin civil gjyqësor, për këshilltarët ligjorë në detyrë në Gjykatën e Lartë

126. Këshilltari ligjor në detyrë në Gjykatën e Lartë është subjekt rivlerësimi kalimtar sipas



nenit 179/b, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Konfirmimi i tij në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar sipas këtij ligji, përbën kusht për pranimin në shërbimin civil gjyqësor.

127. Këshilli, jo më vonë se 7 ditë nga depozitimi pranë tij të vendimit përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar për konfirmimin në detyrë të këshilltarit ligjor në detyrë në Gjykatën e Lartë, mbi propozimin e relatorit të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, e emëron atë në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 165, pika 9, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

C. Verifikimi, emërimi në shërbimin civil gjyqësor ose ndërprerja e marrëdhënieve të punës, për ndihmësligjorët në detyrë në gjykatat administrative

128. Ndihmësligjori në detyrë në gjykatat administrative është subjekt rivlerësimi kalimtar sipas nenit 179/b, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Konfirmimi i tij në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar sipas këtij ligji, përbën kusht për pranimin në shërbimin civil gjyqësor.

129. Ndihmësligjorët në detyrë në gjykatat administrative, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë:

a) ndihmësligjorët në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në të njëjtën detyrë;

b) ndihmësligjorët në detyrë në gjykatat administrative të shkallës së parë emërohen përkohësisht në gjykatat e apelit, si rregull, në gjykatat e apelit që mbulojnë të njëjtin juridiksionin tokësor. Emërimi i përkohshëm bëhet nga Këshilli, jo më vonë se shtatë ditë nga krijimi i njësive të shërbimit ligjor në gjykatat e apelit, mbi propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, duke ruajtur një shpërndarje të drejtë të ndihmësve ligjorë në varësi të nevojave të gjykatave dhe numrit të pozicioneve të lira në ato.

130. Ndihmësligjori që konfirmohet në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 165, pika 9, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtën e caktimit në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të tij aktual dhe për të cilin përmbush kriteret.

131. Kërkesa për t’u caktuar në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor paraqitet përpara Këshillit brenda një muaji pas bërjes përfundimtar të vendimit të organeve të rivlerësimit kalimtar. Në këtë rast marrëdhënia e punës së ndihmësligjorit në gjykatën përkatëse të apelit mbaron në momentin e marrjes së vendimit për kërkesën e paraqitur nga ai sipas kësaj pike.

132. Në rast të mosparaqitjes së kërkesës sipas pikës 131, të këtij vendimi, marrëdhënia e punës së ndihmësligjorit në gjykatën përkatëse të apelit mbaron një muaj pas bërjes përfundimtar të vendimit të organeve të rivlerësimit kalimtar. Këshilli njofton gjykatën përkatëse të apelit për kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ndihmësligjorit në detyrë.

133. Kërkesa sipas pikës 131, të këtij vendimi, shqyrtohet nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Nëse ajo konsiston në caktimin në një pozicion nëpunësi civil gjyqësor në kompetencë të Këshillit, mbahet për shqyrtim. Në rast të kundërt, kërkesa i dërgohet menjëherë për shqyrtim këshillit të gjykatës përkatëse.



134. Për shqyrtimin e kërkesës në kompetencë të Këshillit, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit cakton, me short, si relator, një anëtar të saj.

135. Relatori, brenda dy javëve, verifikon përmbushjen kushteve/kritereve të përgjithshme të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, si dhe të kritereve të veçanta për pozicionin e kërkuar. Komisioni kontrollon plotësinë e verifikimeve të relatorit dhe vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill.

136. Mbi propozimin e relatorit, Këshilli vendos:

a) pranimin e subjektit në shërbimin civil gjyqësor dhe caktimin e tij në pozicionin e kërkuar;

ose

b) refuzimin e kërkesës për caktimin në pozicion dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të përkohshme të punës në funksionin e ndihmësligjorit.

137. Vendimi i Këshillit për pranimin e subjektit në shërbimin civil gjyqësor dhe caktimin në pozicion reflektohet në Regjistrin Qendror të Personelit, të krijuar dhe administruar nga Departamenti i Administratës Publike.

138. Kundër vendimit të Këshillit për refuzimin e kërkesës për caktim në pozicion dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të përkohshme të punës në funksionin e ndihmësligjorit, mund të paraqitet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

139. Në rast se përpara Këshillit, në të njëjtën kohë, janë për shqyrtim disa kërkesa për caktimin në të njëjtin pozicion të të njëjtës gjykatë, nga kategoria e ndihmësve ligjorë të konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, ato shqyrtohen nga i njëjti relator. Caktimi në pozicion në këtë rast bëhet mbi bazë konkurrimi. Këshilli zgjedh kandidatin, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme sipas kësaj radhe:

a) renditjen e tyre në testin e aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, të zhvilluar sipas parashikimeve të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

b) çdo njohuri ose përvojë të veçantë të kandidatit, që e bën atë veçanërisht të kualifikuar për vendin e lirë;

c) vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose në pozicione drejtuese.

140. Kandidatit që nuk është përzgjedhur sipas pikës 139, të këtij vendimi, i ndërpriten marrëdhëniet e përkohshme të punës në funksionin e ndihmësligjorit. Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

141. Nëse ndihmësligjori i konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, caktohet sërish, sipas këtij seksioni, në pozicionin e ndihmësligjorit, atëherë ky vendim konsiderohet si vendim konfirmimi në kuptim të nenit 62, pika 3, shkronja “a”, të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

142. Nëse ndihmësligjori në detyrë i konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, caktohet sipas këtij seksioni, në një pozicion nëpunësi civil gjyqësor të ndryshëm nga ai i ndihmësligjorit, atëherë ky vendim konsiderohet si vendim emërimi paraprak në kuptim të nenit 61, të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

143. Ndihmësligjori në detyrë, të cilit i është refuzuar kërkesa për caktim në pozicion për mosplotësim të kritereve të veçanta sipas nenit 56 të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, mund të kërkojë sistemimin në një pozicion tjetër në administratën e gjykatës. Në këtë rast, Këshilli vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër në administratën e gjykatës, të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale.



XIV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

A. Verifikimi dhe emërimi në shërbimin civil gjyqësor, për kandidatët për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë, që kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019–2020

144. Kandidatët për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë, të cilët kanë kaluar me sukses programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019–2020, mbi propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, emërohen përkohësisht nga Këshilli si këshilltarë ligjorë pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës.

145. Për verifikimin e pasurisë dhe figurës së këshilltarëve ligjorë të emëruar përkohësisht ndiqen të njëjtat rregulla si ato sipas krerëve VI dhe IX, të këtij vendimi.

146. Jo më vonë se 7 ditë nga bërja përfundimtar të vendimit të verifikimit, në varësi të rezultateve, Këshilli vendos:

a) pranimin në shërbimin civil gjyqësor dhe emërimin përfundimtar si këshilltar ligjor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë;

ose

b) shfuqizimin e vendimit të emërimit të përkohshëm dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

B. Verifikimi dhe emërimi në shërbimin civil gjyqësor, për kandidatët për ndihmësligjorë në gjykatat e apelit, që përfundojnë programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019–2020

147. Kandidatët për ndihmë ligjorë në gjykatat e apelit, të cilët kanë kaluar me sukses programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019–2020, i nënshtrohen verifikimit të kushtit të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, verifikimit të pasurisë dhe figurës. Verifikimi fillon jo më vonë se 7 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

148. Për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit për ndihmësligjor në gjykatat e apelit, ndiqen të njëjtat rregulla si ato sipas krerëve VI ose VIII dhe IX, të këtij vendimi.

149. Kandidatët për ndihmësligjorë në gjykatat e apelit, mbi propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, emërohen përkohësisht deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës.

150. Emërimi i përkohshëm bëhet mbas krijimit nga Këshilli të njësive të shërbimit ligjor në gjykatat e apelit dhe shpalljes së vendeve të lira. Ky emërim bëhet mbi bazë konkurrimi, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme sipas kësaj radhe:

a) renditjen në listën e kandidatëve;

b) çdo njohuri ose përvojë të veçantë të kandidatit, që e bën atë veçanërisht të kualifikuar për vendin e lirë;

c) vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose në pozicione drejtuese.

151. Jo më vonë se 7 ditë nga bërja përfundimtar të vendimit të verifikimit, në varësi të rezultateve, Këshilli vendos:

a) pranimin në shërbimin civil gjyqësor dhe emërimin përfundimtar si ndihmësligjor pranë njësive të shërbimit ligjor në gjykatën e apelit përkatës;

ose

b) shfuqizimin e vendimit të emërimit të përkohshëm dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

C. Verifikimi i kandidatëve për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmësligjorë në gjykatat e apelit, të pranuar në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020–2021

152. Kandidatët për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmësligjorë në gjykatat e apelit, që janë pranuar në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020–2021, i nënshtrohen menjëherë verifikimit të pasurisë dhe figurës. Verifikimi fillon jo më vonë se 7 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

153. Për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmësligjor në gjykatat e apelit, ndiqen të njëjtat rregulla si ato sipas krerëve VI dhe IX, të këtij vendimi.



154. Jo më vonë se 7 ditë nga bërja përfundimtare e vendimit të verifikimit, në varësi të rezultateve, Këshilli vendos:

a) për lejimin e vijimit nga kandidati të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës;

ose

b) për ndalimin e vijimit nga ai dhe ndërprerjen e këtij programi.

Ç. Dispozitë e fundit

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETARE

Naureda Llagami

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë